



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:166204

Datë: 11.02.2022

Numri i dokumentit: 02707118

P.nr.1012/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL, në përbërje gjyqtari i vetëm gjykues, Shabi Idrizi dhe bashkëpunëtori profesional Driton Ahmeti, në çështjen penale kundër të pandehurit B.Gj. nga fshati ...-Gjilan, për shkak të veprës penale prezantimi i rremë si person zyrtar nga neni 409 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj në PP.II.nr.1560/20 të datës 27.11.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datën 09.02.2022, në praninë e përfaqësuesit të akuzës prokurorit të shtetit Albert Zejnullahu, të pandehurit B.Gj. me datë 10.02.2022 mori dhe publikisht shpalli ndërsa me datë 11.02.2022 përpiloi, këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **B.Gj.**, nga i ati R. dhe ëma F., e gjinisë B. i lindur me ..., në ... me vendbanim në fshatin ...-Gjilan, me numër personal letërnjoftimit ..., i pamartuar, i gjendjes së dobët ekonomike, ka të kryer shkollën fillore, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës i dënuar më parë, mbrohet në liri

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se,

Me 08 Nëntor 2020, rreth orës 14:20, në rr “...”, në Ferizaj, saktësisht në marketin “...”, prezantohet rrejshëm si person zyrtarë, në atë mënyrë që është paraqitur si Inspektor tregu dhe ka filluar të kontrollojë disa gjëra ushqimore,

-Me këtë ka kryer veprën penale prezantim i rremë si person zyrtar nga neni 409 par.1 të KPK-së

Andaj, Gjykata në bazë dispozitës së lartë shënuar si dhe neneve: 2, 17, 21, 38, 69, 70, 71, 72, 81 dhe 82 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 365, 370, 453, 463, të KPP-së, te pandehurit B.Gj. i shqipton,

V R E J T J E G J Y Q Ë S O R E

Me të cilën të pandehurit i bëhet me dije se ka kryer veprë të dëmshme dhe të rrezikshme që përbën veprë penale dhe nëse kryen prapë veprë të tillë, gjykata do ti shqiptoj sanksion më të rëndë penal.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 20 /tridhjetë/ Euro, si dhe komfor nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit, të paguaj shumën prej 30 /tridhjetë/ Euro, brenda afatit prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore nga Ferizaj, me Aktakuzën e saj PP.II.nr.1560/20 e datës 27,11,2020 ka ngarkuar të pandehurin B.Gj. nga fshati ..., Komuna e Gjilanit, për shkak të veprës penale prezantimi i rremë si person zyrtar nga neni 409 par.1 të KPK-së

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze, caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë: 09.02.2022, në të cilën përfaqësuesi i akuzës-prokurori i shtetit lexoi aktin akuzues, dhe gjyqtari pasi që u bind se e pandehura e ka kuptuar akuzën, komfor nenit 246 par. 4 të pandehurës i ofroj mundësinë që ta pranojë fajësinë ose të deklarohet e pafajshme. Në këtë shqyrtim i akuzuari e pranoi fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës.

Prokurori i shtetit deklaron se: nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga i pandehuri meqë një pranim i tille është bere komfor dispozitave ligjore nga neni 248 te KPPK-së pra ne mënyrë vullnetare nga i cili pranim ka mbështetje ne te gjitha provat dhe shkresat qe përmban aktakuza, i propozoj gjykatës qe ta këtë parasysh pranimin e fajësisë, te njëjtin ta shpall fajtor dhe ti shqiptoj një dënim te paraparë me Kodin Penale te Republikës se Kosovës.

I akuzuari deklaron se shpreh keqardhje dhe është i penduar thellë, ku e lus gjykatën që të më shqiptoj një dënim sa më të butë, dhe i premtun gjykatës se nuk do të përsëris vepra të tilla penale.

Gjykata lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri në seance fillestare të mbajtur me datë 09.02.2022 ku si të tillë prokurori i shtetit nuk e kundërshtoi andaj gjykata morri aktvendim ku pranoi pranimin e fajësisë ku pranimi i tillë është bërë komfor nën 248 par.1 i KPPK.

Gjyqtari gjykues ka vlerësuar se kërkesat nga neni 248 paragrafi 1 i KPPK-së janë përmbushur, pasi që:

- I pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë
- Pranimi është bërë vullnetarisht.
- Pranimi mbështetet në prova dhe fakte të çështjes penale që përmban aktakuza dhe materialet e prezantuara nga ana e prokurorit të shtetit me aktakuzë dhe atë: Raporti i oficerit, si dhe shkresat tjera të cilat gjenden në lëndë.
- akuzat nuk përmban asnjë shkelje ligjore ose gabime faktike,

Me qenë se i akuzuari ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjyqtari individual komfor nën 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit, *(nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale prezantimi i rremë si person zyrtarë nga neni 409 par.1 të KPRK-së, me që me datë, vend dhe kohë siç është përshkruar hollësisht në diapozitivin e këtij aktgjykimi i pandehuri me veprimet e tij ka konsumuar veprën penale që i vihet në barë me çka bërë fillimin e procedurës penale.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoi rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese

përkatësisht që në shqyrtim fillestar i pandehuri ka pranuar fajësinë, pendimi ishte i sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, gjendjen e vështirë ekonomike, kurse në rastin konkret si rrethanë renduese gjeti se ka qenë i dënuar më parë si dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se i akuzuari në të gjitha fazat e procedurës penale ka bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 38 të KPRK-ës përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Komfor neneve 450 dhe 453 të KPPK-ës, obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30€ (tridhjetë eurove), si dhe për fondin e viktimave të dhunës shumën prej 30 € (tridhjetë) në afatin prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nga data e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2020:166204, 10.02.2022

G j y q t a r i

Shabi Idrizi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimin të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.